



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:165074  
Datë: 23.05.2024  
Numri i dokumentit: 05724001

**AC.nr.10372/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi -Kryetar i Kolegjit, Lumni Sallauka dhe Hunaida Pasuli, antarë të kolegjit, në çështjen juridiko-civile jo kontestimore të propozuesit Sh..... K..... nga fshati Sllovi, të cilin me autorizim e përfaqëson H..... K....., av. nga Lipjani, kundër kundër propozuesit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson N..... A....., avokate nga avokatura shtetërore e Ministrisë së Drejtësisë, për caktimin e lartësisë së kompensimit për paluajtshmërinë e shpronësuar dhe uljen e vlerës së paluajtshmërisë së pa shpronësuar, duke vendosur lidhur me ankesën e kundër propozuesit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, CN.nr.97/2018 të datës 13.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **21.05.2024**, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET E PA BAZUAR** ankesa e kundër propozueses Qeveria e Kosovës- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm CN.nr. 97/2018, i datës 13.10.2021 **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë, në dispozitivin e aktvendimit të saj e ka aprovuar propozimin e propozuesit Sh..... K..... nga fshati Sllovi, dhe ka ndryshuar vendimi përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.12/71 të datës 23.10.2018 dhe akt vlerësimi për pronat për shpronësim për interes publik të cilat preken nga realizimi i Projektit “Autostrada A 7.1 Prishtine-Gjilan-Dheu i Bardhe”, të Departamentit të Tatimit në Pronë të Ministrisë së Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 17.08.2018, sa i përket pjesës së shpronësuar të sipërfaqes prej 7879m<sup>2</sup> të parcelës nr.2267-1 në ZK Sllovi dhe pjesës së shpronësuar të sipërfaqes prej 5796m<sup>2</sup> të parcelës nr.2266-0, në ZK Sllovi dhe ka obliguar Qeverinë e Kosovës - Ministria

e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, që propozuesit t'ia paguaj kompensimin shtesë për pjesët e shpronësuara të parcelës nr.2267-1, në sipërfaqe prej 7879m<sup>2</sup> në shumë prej 27.576.50 € dhe për pjesën e parcelës nr.2266-0 në sipërfaqe prej 5796m<sup>2</sup> në shumë prej 17.388.00 euro si dhe në emër të uljes së vlerës në pjesët e pa shpronësuara të parcelës nr.2267-1 në sipërfaqe prej 16651m<sup>2</sup> shumën prej 11.655,00 euro dhe të parcelës nr.2266-0 në sipërfaqe prej 396m<sup>2</sup> shumën prej 4.435,00 euro, për shkak të pjesëve të shpronësuara të këtyre parcelave, që të gjitha këto shuma me kamatë prej 7% të interesit vjetor nga data 06.11.2018 e deri tek pagesa definitive, si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës jo kontestimore në shumë prej 1,707.20 euro, të gjitha këto shuma në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktvendimi në afatin e përcaktuar ligjor, ankesë ka ushtruar kundër propozuesja Qeveria e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës jo kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë si të bazuar ankesën duke e lënë në fuqi Raportin e vlerësimit të Organit Shpronësues.

Propozuesi nuk ka ushtruar përgjegjje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 194 dhe 195 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJ) dhe gjeti se:

#### **Ankesa e kundër propozueses është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se propozuesi Sh..... K....., përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij, H..... K....., avokat nga Lipjani, me datë 29.11.2018 ka ushtruar propozim për caktimin e shpërblimit të paluajtshmërisë së shpronësuar. Në seancat gjyqësore të mbajtura, ka theksuar se me vendimin përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.12/71, të datës 23.10.2018, janë shpronësuar pjesërisht ngastra e propozuesit nr. 2267-1, ZK Sllovi, në sipërfaqe prej 7879 m<sup>2</sup> dhe ngastra nr. 2266-0, ZK Sllovi, në sipërfaqe prej 5796 m<sup>2</sup>, për ndërtimin e autostradës Prishtinë - Gjilan – Dheu i Bardhë, por propozuesi konsideron se vlerësimet e pronave të shpronësuara nuk janë të drejta, përkatësisht nuk është shpërblyer vlera reale e paluajtshmërive të shpronësuara nga organi kompetent, ndërsa për pjesët e pa shpronësuara në sipërfaqe prej 16651 m<sup>2</sup> të ngastrës kadastrale nr.2267-1, dhe në sipërfaqe prej 396 m<sup>2</sup> të ngastrës kadastrale 2266-0, propozuesi ka pësuar dëm, me arsyetim se pjesës së pa shpronësuar i është ulur vlera. Me parashtrësën me shkrim ka bërë precizimin e propozimit, me të cilin ka kërkuar që të obligohet kundër propozuesja që propozuesit t'ia kompensoj në emër të ndryshimit të çmimit për paluajtshmërinë e shpronësuar si dhe për zvogëlimin e vlerës së pronës së pa shpronësuar të ngastrës kadastrale nr. 2267-1, shumën prej 39,231.50 euro dhe në emër të ndryshimit të çmimit për paluajtshmërinë e shpronësuar si dhe për zvogëlimin e vlerës së pronës së pa shpronësuar të ngastrës kadastrale nr. 2266-0, shumën prej 21,823.00-€ ,të gjitha këto shuma me kamatë prej 7% nga dita kur ka hy në fuqi vendimi përfundimtar i shpronësimit e deri

te pagesa definitive. I ka propozuar gjykatës që ta miratoj propozimin e precizuar si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas TOAK-ës.

E autorizuar e kundër propozuesit e ka kundërshtuar propozimin e precizuar të propozuesit, duke theksuar se raporti i vlerësimit të organit shpronësues ka qenë raport i drejtë, i cili është bazuar në ligjin mbi shpronësimin e pronave të paluajtshme dhe në aktin administrativ 2/15, dhe caktimi i vlerës së pronave ka qenë i përshtatshëm me kohën kur është bërë shpronësimi, ndërsa sa i përket pronës së pa shpronësuar me ekspertizën gjeodezike dhe deklaratimet e ekspertit u vërtetua se nuk mund të ketë humbje të vlerës të parcelave të pa shpronësuar, ngase kanë qasje direkte në rrugë si para shpronësimit ashtu edhe pas shpronësimit, duke i propozuar gjykatës që gjatë marrjes së vendimit mos ta merr parasysh mendimin e ekspertit vlerësues. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pabazuar propozimi i propozuesit dhe të mbetet në fuqi vendimi përfundimtar i Qeverisë së Kosovës. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas procedimit dhe administrimit të provave, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar duke vendosur më specifikuisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata ka theksuar se me vendimin përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.12/71 të datës 23.10.2018, është aprovuar shpronësimi për interes publik, përveç pronave tjera edhe për paluajtshmëritë në ZK Sllovi, për ndërtimin e autostradës Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë, segmenti Banullë - Bresalc, e ku është përfshirë edhe një pjesë e ngastrës nr. 2267-1, në sipërfaqe prej 7879 m<sup>2</sup>, ZK Sllovi, dhe një pjesë e ngastrës nr. 2266-0, në sipërfaqe prej 5796 m<sup>2</sup>, ZK Sllovi, që të dy këto ngastra në pronësi të propozuesit. Me akt vlerësim për pronat për shpronësim për interes publike të cilat preken nga realizimi i Projektit “Autostrada A 7.1 Prishtine-Gjilan-Dheu i Bardhe” të Departamentit të Tatimit në Pronë të Ministrisë së Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 17.08.2018, pjesa e ngastrës së shpronësuar nr.2267-1, në sipërfaqe prej 7879 m<sup>2</sup> në ZK Sllovi, është vlerësuar 10.50 euro për metër katror, përkatësisht sipërfaqja e shpronësuar është vlerësuar në lartësi të tërësishme prej 82,729.50 euro, ndërsa, pjesa e ngastrës së shpronësuar nr.2266-0, në sipërfaqe prej 5796 m<sup>2</sup> në ZK Sllovi, është vlerësuar 11.00 euro për metër katror, përkatësisht sipërfaqja e shpronësuar është vlerësuar në lartësi të tërësishme prej 63,756.00 euro. Në raportin e vlerësimit të hartuar nga eksperti gjyqësor B..... S..... – vlerësues i pronave të paluajtshme, i datës 06.09.2021, ngastra nr. 2267-1 e shpronësuar është vlerësuar në shumë prej 14.00. euro për 1m<sup>2</sup>, përkatësisht pjesa e shpronësuar e ngastrës kadastrale në sipërfaqe prej 7879 m<sup>2</sup>, është vlerësuar në shumë prej 110,306.00 euro dhe ndryshimi nga vlerësimi i organit shpronësues për këtë sipërfaqe të ngastrës kadastrale të shpronësuar është në lartësi prej 27,576.50 euro, ndërsa për pjesën e pa shpronësuar në sipërfaqen prej 16651 m<sup>2</sup>, të të njejtës ngastër kadastrale, ka dhënë mendim se për shkak të shpronësimit të pjesës së shpronësuar, në pjesën e pronës së pa shpronësuar në sipërfaqe prej 16651 m<sup>2</sup>, ka ulje të vlerës në lartësi prej 5%, dhe propozuesi ka pësuar dëm për pjesën e pa shpronësuar në lartësi prej 11,655.0 euro nga se pjesa e mbetur jashtë shpronësimit ka humbur madhësinë, formën, pozitën dhe qasjen në rrugë, kurse ngastra nr. 2266-0, e shpronësuar është vlerësuar në shumë prej 14.00 euro për 1m<sup>2</sup>, përkatësisht pjesa e shpronësuar e ngastrës kadastrale në sipërfaqe prej 5796 m<sup>2</sup>, është vlerësuar në shumë prej

81,144.00 euro dhe ndryshimi nga vlerësimi i organit shpronësues për këtë sipërfaqe të ngastrës kadastrale të shpronësuar është në lartësi prej 17,388.00 euro, ndërsa për pjesën e pa shpronësuar në sipërfaqen prej 396m<sup>2</sup>, të të njëjtës ngastër kadastrale, ka dhënë mendim se për shkak të shpronësimit të pjesës së shpronësuar, në pjesën e pa shpronësuar në sipërfaqe prej 396 m<sup>2</sup>, ka ulje të vlerës në lartësi prej 80%, dhe propozuesi ka pësuar dëm për pjesën e pa shpronësuar në lartësi prej 4,435.00 euro nga se pjesa e mbetur jashtë shpronësimit është parcelizuar duke humbur madhësinë, formën, pozitën dhe qasjen në rrugë arsye të cilat e pamundësojnë punimin e tokës për çka pengohet aplikimi i masave agro-teknike. Gjykata ia fali besimin mendimit dhe konstatimit të ekspertit, ngase i njëjti është përpiluar në bazë të rregullave dhe e bazuar edhe në nenin 8 dhe 10 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 për Miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për llogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësim. Nga certifikatat për njësi kadastrale P-71409077-02267-1 dhe P-71409077-02266-0, që të dyja në ZK Sllovi, të lëshuara me datë 08.11.2016, rezulton se ngastrat janë të regjistruara në emër të propozuesit Shaban Kryeziu. Nga ekspertiza e gjeodezisë e hartuar nga ekspertja gjyqësore Dafina Tmava - Gashi, gjeodete e licencuar, rezulton se para shpronësimit ngastra nr. 2267-1, nuk ka pasur qasje direkte në rrugë, por mund të ketë qasje në të njëjtën duke e shfrytëzuar parcelën 2266-0, e cila parcele është në emër të propozuesit, kurse ngastra 2266-0, para shpronësimit edhe pas shpronësimit ka qasje direkte në rrugë. Bazuar në të lartcekurat, gjykata e aprovoi në tërësi si të bazuar propozimin e propozuesit duke e mbështetur vendimin e saj në nenin 15, pika 1, nenin 18, pika 3, nenin 37 të Ligjit nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Vendimi për kamatën është bazuar në dispozitën e nenit 16, pika 2.1 të Ligjit nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, me shkallë të kamatës vjetore prej 7% duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të vendimit përfundimtar e deri te pagesa definitive, ndërsa për sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 222 të Ligji Nr.03/L-007 i Procedurës Jo kontestimore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (n) e LPK-së dhe atyre jokontestimore, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore dhe jo kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes në këtë çështje jo kontestimore, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe jo kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj, drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye, aktvendimi i atakuar është dashur të vërtetohet në tërësi. Gjithashtu, edhe dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke krijuar kështu harmoni logjike e juridike mes dispozitivit e arsyetimit. Përkatësisht, i njëjti është hartuar në përputhje të plotë me nenin 160, lidhur me nenin 175 të LPK-së. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë

vendimtare, e në lidhshmëri me këtë, ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Për këto arsye, refuzohen si të pabazuara pretendimet ankimore të palës kundër propozueses, të cilat ndërlidhen me çështjet e cekura më lartë.

Me rastin e shqyrtimit të aktvendimit të atakuar dhe të ankesës së parashtruar, fillimisht, Gjykata e Apelit e konsideron si të pabazuar, pretendimin ankimor të kundër propozueses e cila në ankesë thekson se propozimi është i pasafatshëm, e kjo për faktin se në shkresat e lëndës vërtetohet se Vendimi përfundimtarë Nr.12/71 i datës 23.10.2018, është publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 06.11.2018, ndërsa propozuesi propozimin e ka parashtruar me datë 29.11.2018, nga kjo vërtetohet se i njëjti është parashtruar brenda afatit të përcaktuar ligjor. Në nenin 11.7 të LIGJI Nr. 03/L-205 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-139 PËR SHPRONËSIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME, parashihet “Vendimi Përfundimtar hyn në fuqi pas shpalljes në përputhje me të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin 6. të nenit 11 dhe nenin 43 të këtij ligji”, ndërsa në nenin 36.3 parashihet “Çdo ankesë e lartpërmendur duhet të paraqitet jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarike pas hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar të përcaktuar në paragrafin 7. të nenit 11 të këtij ligji. Nëse ankesa paraqitet pas skadimit të kësaj periudhë tridhjetë (30) ditore, ajo do të refuzohet nga gjykata”. Nga kjo shihet se propozimi i propozuesit është brenda afatit të përcaktuar ligjor, dhe pretendimi i të paditurës për mosafatshëmri është i pa bazuar.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të pabazuara pretendimet e palës ankuese për arsye se nga provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, përkatësisht nga ekspertiza e ekspertit vlerësues B.....S..... e datës 06.09.2021 dhe sqarimet e dhëna në seancën e datës 14.09.2021, ka rezultuar se organi shpronësues për shpronësimin e ngastrës kadastrale 2267-1 nuk e ka vlerësuar sipas çmimit apo vlerës reale në treg, ndërsa nga ekspertiza e ekspertit vlerësues rezulton se për këtë ngastër vlera reale e çmimit është 14.00 për m<sup>2</sup>, ndërsa pjesa e mbetur jashtë shpronësimit ka humbur vlerat e saj për 5% nga çmimi kryesor për shpronësim. Gjithashtu, për ngastrën kadastrale 2266, organi shpronësues nuk e ka vlerësuar sipas çmimit apo vlerës reale në treg, ndërsa nga ekspertiza e ekspertit vlerësues rezulton se për këtë ngastër vlera reale e çmimit është 14.00 për m<sup>2</sup>, , ndërsa pjesa e mbetur jashtë shpronësimit ka humbur vlerat e saj për 80% nga çmimi kryesor për shpronësim. Nga ekspertiza e gjoedezisë e hartuar nga ekspertja gjyqësore Dafina Tmava - Gashi, gjeodete e licencuar, rezulton se para shpronësimit ngastra nr. 2267-1, nuk ka pasur qasje direkte në rrugë, por mund të ketë qasje në të njëjtën duke e shfrytëzuar parcelën 2266-0, e cila parcele është në emër të propozuesit, kurse ngastra 2266-0, para shpronësimit edhe pas shpronësimit ka qasje direkte në rrugë.

Në lidhje me këtë, për caktimin e shumës së kompensimit të paluajtshmërive të shpronësuarra dhe zvogëlimit të vlerës së atyre të pa shpronësuarra, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë i ka falur besimin ekspertizës së datës 06.03.2021, e cila ekspertizë në fjalë është përpiluar në pajtim me dispozitat ligjore të cilat i rregullojnë këto çështje, konform nenit 15 par.1 dhe 2, nenit 18 par.3 dhe nenit 37 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139.

Një qëndrim të tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë, e mbështet plotësisht edhe gjykata e shkallës së dytë. Kjo për arsye se gjykata me të drejtë ka vlerësuar se me rastin e shpronësimit me vendimin përfundimtar të palës kundërpropozueses, ngastrat kadastrale nuk janë vlerësuar realisht nga pala kundërpropozuese, ku me rastin e vendosjes gjykata mori për bazë raportin e ekspertizës së ekspertit vlerësues të caktuar nga gjykata për rivlerësimin e çmimeve për palujtshmërinë e shpronësuar dhe pjesën që ka mbetur jashtë shpronësimit, të përcaktuar në Raportin e Vlerësimit, i cili duke iu referuar të gjitha shkresave të lëndës, ka vlerësuar se për sipërfaqen e shpronësuar për sa u përket pjesëve të shpronësuara të sipërfaqeve prej 7879 m<sup>2</sup> të ngastrës kadastrale nr. 2267-1, sipërfaqes prej 5796 m<sup>2</sup> të ngastrës nr.2266-0, të gjitha këto ngastra në ZK Sllovi, si dhe obligohet Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, që propozuesit të ia paguaj kompensimin shtesë për sipërfaqet e shpronësuara prej 7879 m<sup>2</sup> të parcelës për 2267-1 në shumë prej 27.576,50 euro, të sipërfaqes prej 5796 m<sup>2</sup> të ngastrës nr. 2266-0 shumë prej 17.388,00 si dhe në emër të dëmtuljes së çmimit për sipërfaqet e pa shpronësuara të parcelës nr. 2267-10, në sipërfaqe prej 16651 m<sup>2</sup> shumë prej 111.655,00 dhe të parcelës nr. 2266-0, në sipërfaqe prej 396 m<sup>2</sup> shumë prej 4.435,00 euro.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se nuk janë vlerësuar realisht ngastrat kadastrale dhe këtë fakt e ka vërtetuar me ekspertizën e datës 06.09.2021, të ekspertit vlerësues B....S....., ku i njëjtit ka dhënë mendim profesional, duke vlerësuar në mënyrë të gjithanshme, dhe duke sqaruar mbi bazën e çfarë parametrave dhe kushteve i ka dhënë këto vlerësime. Njëherit eksperti vlerësues në raportin vlerësues të tij ka sqaruar se e ka shfrytëzuar mundësinë për të bërë një studim dhe analizë lidhur me volumin e transaksioneve-shtitblerjeve të paluajtshmërive në një periudhë brenda 3 viteve të kaluara e gjerë më tani, por meqë është fjala për periudhë të caktuar duke zbatuar nenin 5, pika 4, të udhëzimit Administrativ nr.02/2015, të datës 07.08.2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve të vlerësimit që përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin, shitblerjet e ndodhur më të hershme se 3 vite para shpronësimit janë eliminuar nga trajtimi, ndërkaq nuk ka marr për bazë shitblerjet e realizuara pas datës së shpronësimit të ngastrave kadastrale që janë objekt lëndor në këtë rast. Lidhur me vlerësimin dhe përcaktimin e çmimit të pronës, eksperti ka marr për bazë çmimet nga vet organi shpronësues për disa prona tjera në zonën ku ndodhen pronat objekt i vlerësimit në këtë çështje. Gjykata e shkallës së parë, të njëjtës ekspertizë me të drejtë ia fali besimin, andaj edhe Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi qëndrimin dhe përfundimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me vendosjen meritorë dhe refuzoi të gjitha pretendimet ankimore të kundërpropozueses të paraqitura me ankesë si pretendime të paqëndrueshme, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Meqë aktvendimi i atakuar është vërtetuar në tërësi për atë që është vendosur lidhur me shumë e kompensimit, atëherë automatikisht vërtetohet edhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me shpenzimet procedurale, të cilat gjykata e shkallës së parë i ka caktuar në bazë të dispozitës së nenit 222 të LPJ-së dhe 452 të LPK-ës, ndërsa vendimin për kamatën e ka marrë në bazë të nenin 16 par. 2, nen par. 2.2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur.

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195.1, pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**AC.nr.10372/21, me datë 21.05.2024**

**Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari**  
**Ardian Ajvazi**